



Përshëndetje nga INDONEZIA!

Mëso rreth fëmijëve të Atit
Qiellor kudo nëpër botë.



Indonezia është një shtet në
Azinë Juglindore. Ajo ka më
shumë se 17 000 ishuj! Pothuajse
280 milionë njerëz jetojnë atje.



NJË KISHË NË RITJE

Presidenti Rasëll M. Nelson vizitoi anëtarët
e kryeqytetit, Xhakartës, në vitin 2019. Në
konferencën e përgjithshme të prillit 2023, ai
lajmëroi se atje do të ndërtohej një tempull!

VENDET E ADHURIMIT



Indonezia ka xhaminë
më të madhe islamike
në Azinë Juglindore. Ajo
ka edhe tempullin më të
madh budist në botë.

NJË VULLKAN BLU!

Indonezia ka më shumë vullkane
aktive sesa çdo vend tjetër.
Vullkani Kaua-Ixhen ka flakë blu
që mund të shihen natën.

A E FLET GJUHËN TIME?

Selamat
pagi!

Halo!

Rahajeng
semeng!



Indonezishtja është gjuha zyrtare. Por në
Indonezi fliten më shumë se 700 gjuhë! Motoja
e vendit të tyre do të thotë "Shumë, megjithatë
një" për të treguar se janë të bashkuar.

SHTËPIA E DRAGONJVE

Dragonjtë Komodo janë hardhucat
më të mëdha në botë. Ato mund
të rriten deri në 3 metra të gjata!

ILUSTRIMET NGA CONNER GILLETTE



VEPRIMTARIA

PIKTURË NË STILIN BATIK

Stili batik është një lloj arti që i shton
ngjyrë cohës. Mund të bësh edhe ti
diçka të tillë!

Bëj një model në letër me ngjites
të lëngshëm. Kur të thahet, pikturo
mes vijave të ngjitesit me bojëra uji.




NASI UDUK

RECETA

1. Shpëlaj **2 gota me oriz të bardhë**.
Lëre orizin në ujë për një orë, më
pas kulloje.
2. Në një tenxhere më vete, hidh **2 gota
krem të arrës së kokosit**. Më pas
shto **2 sytha të tharë karafili**,
1 shkop kanelle dhe **1 lugë çaji
kripë**. Trazoje dhe lëre të vlojë.
3. Shtojte orizin te salca. Vëri kapakun
dhe gatujte në zjarr të ulët për 15-20
minuta derisa orizi të zbutet.
4. Hiqe nga nxehtësia dhe lëre me
kapak për 10 minuta. Shërbeje me
vezë të ziera fort, qepë të skuqura ose
shoqëruese të tjera.

Sigurohu që të
të ndihmojë një
i rritur!



GJUMI I MIRË GJATË NATËS

Ne kemi nevojë për gjumë që të kemi
energji për të vrapuar, luajtur dhe
punuar. Përpiqu të shkosh në shtrat
në të njëjtën orë çdo natë. Bëj diçka
që të të ndihmojë të qetësohesh
përpara se të biesh për të fjetur.

KËSHILLË E
SHËNDËTSHME